

---

**Faturimi i Qytetarëve dhe Parimet  
për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për Ngrohtoren e Qytetit Termokos  
SH.A. Sezoni i Ngrohjes 2018/2019**

---

**PROPOZIM POLITIKASH**

---

10/2018



# Faturimi i Qytetarëve dhe Parimet për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për Ngrohtoren e Qytetit Termokos SH.A. Sezoni i Ngrohjes 2018/2019

---

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm & Qeverisje Demokratike**

Publikimi: **Shtator 2018**

Foto e ballinës: **VisualHunt**



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development



**Qeverisja Demokratike**  
Democratic Governance

## Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



**Rockefeller  
Brothers  
Fund**

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondacionit të Vëllezërve Rockefeller. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

## Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), në kuadër të programit për zhvillim të qëndrueshëm dhe programit për qeverisje demokratike ka analizuar Raportin Rregullativ për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për Ngrohoren e Qytetit Termokos SH.A. për Sezonin e Ngrohjes 2018/2019. INDEP ka bazuar punën duke marrë parasysh mbrojtjen e konsumatorit, eficiencën e energjisë dhe sigurimin e një tregu funksional të furnizimit me ngrohje.

Ndërmarrja publike Termokos, ka parë një transformim të teknologjisë dhe burimit të ngrohjes që ofron për qytetarët e Prishtinës. Në anën tjetër, struktura tarifore për konsumatorët fundorë për ngrohjen të cilën e marrin ende nuk ka ndryshuar. Që në hyrje të dokumentit që po e shqyrtojmë, ZRRE ka shpallur se për përcaktimin e metodologjisë tarifore janë marrë për bazë “parimet e mos-diskriminimit dhe arsyeshmërisë”<sup>1</sup>. Në anën tjetër siç do të shohim, në përmbajtje të saj nuk janë trajtuar disa nga elementet që e bëjnë tarifimin e tanishëm thellësisht diskriminues dhe të padrejtë.

Ngrohja është një nga produktet bazë të qytetarëve të Kosovës. Në situatë të tillë dhe duke marrë parasysh monopolin që ekziston, është e domosdoshme një faturim i drejtë dhe i bazuar me një listë të qartë të kriterëve të faturimit për qytetarët e Kosovës. Cilësia e shërbimeve dhe eficientia e ofrimit të tyre duhet të jetë kriteri bazë mbi të cilin pastaj duhet të kalkulohen kostot dhe të përcaktohen të hyrat maksimale të lejuara.

## Parimet e faturimit të qytetarëve për ngrohje

Që në Kushtetutën e Republikës së Kosovës përcaktohet se të garantohet mbrojtja e konsumatorëve, në pajtim me ligjin<sup>2</sup>. Më tutje, në pjeësën e shpjegimit të rolit të ndërmarrjeve publike, aty thuhet se shërbimet publike të detyrueshme mund të imponohen mbi këto ndërmarrje në pajtim me ligjin, i cili duhet të përcaktojë edhe kompensimin e drejtë<sup>3</sup>. Përveç përcaktimeve kushtetuese, ekzistojnë edhe dispozita ligjore të cilat e garantojnë të drejtën e konsumatorit për të marrë shërbime cilësore dhe për të paguar bazuar në konsumin që e bënë.

Ligji Nr. 06/L-064 për Mbrojtjen e Konsumatorit përcakton qartë që përcaktimi i çmimeve për qytetarët bëhet vetëm në bazë të konsumit që qytetari realizon. Faturimi i energjisë, ngrohjes dhe ujit llogaritet në bazë të konsumit real të lexuar në njehsorin e kalibruar të konsumatorit<sup>4</sup>. Me këtë rast, faturimi i cili anashkalon sasinë e konsumit të shërbimit të cilin e merr qytetari është i jashtëligjshëm.

Gjithashtu, Kosova ka obligime të marra edhe në raport me agjendën e integritimit evropian. Në këtë kuptim, është në obligimin e Kosovës që të respektojë Direktivat Evropiane që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorit, eficiencën e energjisë, shërbimet e kompanive publike etj.

---

<sup>1</sup> Zyra e Rregullatorit për Energji, (2018), Raport Rregullativ për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për Ngrohoren e Qytetit Termokos Sh.A, Hyrje faqe 3, Prishtinë: ZRRE.

<sup>2</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, (2008), Neni 119 – Marrdhëniet Ekonomike, Prishtinë: GZRKS.

<sup>3</sup> Ibid.

<sup>4</sup> Republika e Kosovës, (2018), Ligji Nr. 06/L-064 për Mbrojtjen e Konsumatorit, neni 25 – Faturimi i Shërbimeve Publike, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16551> (qasur në shtator, 2018).

Komisioni Evropian ka përcaktuar parimet dhe synimet kryesore të Strategjisë Evropiane për Ngrohje dhe Ftohje:

- Dekarbonizimi i ndërtesave përmes efijencës së lartë dhe standardeve për energji të ripërtrishme për ndërtesa të reja dhe të renovuara,
- Automatizim të sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes përmes përdorimit të sistemeve të dekarbonizuara të ngrohjeve dhe ftohjeve qendrore,
- Efijenca në përdorim<sup>5</sup>.

Të gjitha këto parime, nuk respektohen nga sistemi i tanishëm i faturimit për metër katrorë dhe jo për produkt të shpenzuar siç kërkon Ligji Nr. 06/L-064 për Mbrojtjen e Konsumatorit. Në fakt, ngrohja e qytetit po shkelë ligjin me këtë lloj faturimi. Mirëpo, ne e kuptojmë që kostoja e instalimit të matësve është e lartë dhe madje jemi të inkurajuar që në dokument janë përmendur “Planifikimet për faturimin e konsumatorëve bazuar në furnizim/konsumin e matur”. Për këtë, deri në instalimin e matësve që do të faturojnë qytetarët bazuar në konsum dhe duke llogaritur sasinë e ngrohjes së ofruar, konsiderojmë që është i domosdoshëm një ndryshim në strukturën aktuale të faturimit.

Në këtë situatë, INDEP në vazhdim propozon ndryshimet në faturimin aktual me të cilat do të sigurohet deri në një masë, një faturim më i drejtë dhe efijencë më e lartë e përdorimit të resurseve të ngrohjes. Vetëm në këtë mënyrë, në sezonën në të cilën po hyjmë, mund të kemi shfrytëzim të drejtë dhe faturim bazuar në ngrohjen që qytetarët e pranojnë.

## Ngrohje dhe çmime bazuar në temperature

Sasia e ngrohjes por edhe çmimi i saj duhet të varen nga temperaturat që shfaqen në kohën kur merret shërbimi i ngrohjes. Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës apo ndonjë institucion tjetër i dakorduar nga ZRRE, Termokosi dhe qytetarët, duhet të merret si pikë referente për të përcaktuar faturimin e qytetarëve bazuar në tempëeraturën mesatare të pjesës së ditës.

Faturimi i plotë i qytetarëve edhe kur ditët e p.sh. tetorit apo prillit janë të ngrohta nuk është i drejtë. Në të njëjtë kohë, edhe faturimi i njëllotë kur temperaturat janë 8°C dhe kur ato janë -20°C nuk është i drejtë. Modeli i faturimit të shpenzimeve bazuar në parashikime afatshkurtëra të motit shihet si një mënyrë për të modernizuar sistemin e ngrohjes.

Ngrohja e bazuar në temperatura minimale dhe maksimale dhe faturimi i bazuar në mot janë modele të njohura edhe në studimet e Bankës Botërore. Masat efijente nga aspekti i kërkesës për energji, përfshirë faturimi në bazë të temperturës ulin të paktën 20-30% kërkesën për ngrohje<sup>6</sup>. Kjo

**Nëse qytetari nuk mund të ulë shpenzimin duke ulur temperaturën në matës, përse Termokosi nuk ulë çmimin bazuar në temperaturat e motit?**

<sup>5</sup> Komisioni Evropian, (2016), EU Heating and Cooling Strategy- A path to decarbonising homes and industry, Bruksel: KE.

<sup>6</sup> Banka Botërore, (2012), Modernization of the District Heating Systems in Ukraine: Heat Metering and Consumption-Based Billing, ESMAP:WB.

automatiksht nënkupton më shumë potencial për zgjerim të rrjetit dhe përfshirje të më shumë konsumatorëve në rrjetin e ngrohjes.

Pagesa e çmimit	
Temperaturat	Niveli i pagesës
Mbi 10°C	<b>20%</b> <sup>7</sup>
0 deri 10°C	<b>40%</b>
0 deri -5°C	<b>80%</b>
>-5°C	<b>100%</b>

Faturimi në bazë të temperaturave momentale apo në projeksion të parashikimit afatshkurtër të tyre nënkupton mbrojtje e drejtëpërdrejtë e konsumatorëve për shkak se të njëjtit paguajnë njëjtë për një shërbim të cilin nuk e shfrytëzojnë kur temperaturat janë më të larta. Është abuzim me konsumatorët që në një kohë u ofrohet shërbimi pa opsion të kursimit me qëllim të uljes së kostos, e në të njëjtën kohë çmimi nuk dallon pavarësisht temperaturave.

## Ndarje tarifore ditë-natë

Një tjetër element i cili mund të ndikoj që faturimi të bazohet në kërkesën dhe nevojën për ngrohje është edhe ndarja e çmimeve sipas tarifës së lartë (natë) dhe tarifës së ulët (ditë). Kjo ndarje reflekton konsumin real të ngrohjes dhe mbron konsumatorët nga faturimi edhe në periudha kur temperaturat janë më të larta dhe shfrytëzimi i ngrohjes është dukshëm më i lartë.

- Tarifë e ulët (nga ora 6 në mëngjes në ora 18 në mbrëmje),
- Tarifë e lartë (nga ora 18 deri në 6 në mëngjes).

## Kontrata individuale me konsumatorë

Termokosi duhet të nënshkruaj kontrata individuale me furnizim të konsumatorëve. Në to, duhen specifikuar kushtet e kontratës dhe të drejtat e konsumatorëve. Furnizuesi detyrohet që konsumatorit t'ia mundësojë paraprakisht njoftimin me të gjitha kushtet e konsumit të energjisë, ngrohjes dhe ujit<sup>8</sup>. Pra, ky është edhe njëri nga obligimet që Ligji Nr. 06/L-064 për Mbrojtjen e Konsumatorit ka vendosur për ndërmarrje që ofrojnë furnizim me energji. Gjithashtu, ndër të drejtat themelore të konsumatorit është edhe njoftimi për të drejtat dhe obligimet e konsumatorëve dhe anasjelltas. Duke nënshkruar dhe renovuar kontratat individuale me konsumatorë, edhe Termokosi do ta ketë më të lehtë mbledhjen dhe menaxhimin e borgjeve, identifikimin e konsumatorëve në nevojë etj.

<sup>7</sup> Vlera në përqindje është ndaj çmimit bazë të rregulluar që vlenë 100% kur temperaturat arrijnë nën -5°C.

<sup>8</sup> Republika e Kosovës, (2018), Ligji Nr. 06/L-064 për Mbrojtjen e Konsumatorit, neni 25 – Faturimi i Shërbimeve Publike, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16551> (qasur në shtator, 2018).

## **Përfundime dhe rekomandime**

Instituti për Politika Zhvillimore konsideron se çfarëdo vlerësimi i të hyrave të lejuara për Termokosin dhe strukturës tarifore duhet të ketë parasysh faktin se ekziston një faturim i padrejtë për konsumatorët. Konsumatorëve u imponohet një periudhë e ngrohjes që jo gjithmonë konsiston me nevojën për ngrohje, nuk faturohen as në bazë të konsumit as të kualitetit të shërbimeve.

Ndonëse ZRRE ndoshta nuk mund të trajtojë të gjitha këto çështje në trajtimin e të hyrave maksimale të lejuara, është në përgjegjësinë kushtetuese dhe ligjore të Zyrës së Rregullatorit për Energji që të mbrojë interesin publik të qytetarëve dhe të drejtat e konsumatorit. Fundja, ndërmarrjet publike ekzistojnë për të ofruar shërbime cilësore të domosdoshme. Për këtë, në prioritet të ZRRE-së nuk duhet të jetë realizimi i fitimit të domosdoshëm për ndërmarrjen, por rritja e cilësisë së shërbimit dhe ruajtja e përballueshmërisë së çmimeve për konsumatorët.

INDEP konsideron që është e domosdoshme që për sezonën dimërore në të cilën po hyjmë, 2018-2019 ZRRE të sigurohet se ndërmarrja ka marrë disa masa me qëllim të llogaritjes më të drejtë të kostove të ngrohjes për konsumatorët. Tani kur matësit individual është e pamundur të vendosen për këtë sezonë, të paktën ndërmarrja duhet të shkallëzoj çmimet në bazë të tarifës së lartë (natën) dhe tarifës së ulët (ditën). Gjithashtu, është e domosdoshme që çmimi të ndërlihet me nevojën për ngrohje (temperaturën në kohë reale).

Më në fund, ZRRE duhet të ketë parasysh që konsumatorët kanë të drejtë ligjore për informim të rregullt mbi produktin që konsumojnë dhe të drejtat e tyre. Ndërmarrjet publike që kanë monopol, të tilla si Termokosi, duhet medoemos të nënshkruajnë kontrata individuale me konsumatorët. Vetëm duke vënë qytetarët në rend të parë, rrjeti do të ketë më shumë kapacitet për të ofruar ngrohje për më shumë qytetarë, do të ketë inkasim më të mirë dhe shfrytëzim më efikas të resurseve të ngrohjes.

